

KONTRATË
PËR SHITJEN DHE TRANSFERIMIN E PJESËVE TË KAPITALIT
TË SHOQËRISË SAMASOL SHPK

Sot, më 05.07.2024, nënshkruhet kjo kontratë për shitjen dhe transferimin e pjesëmarrjes në kapitalin themeltar të shoqërisë Samasol shpk (këtu e më poshtë quajtur "**Kontrata**") ndërmjet palëve si më poshtë:

Z. Artur GAÇAJ, shtetas shqiptar, lindur me 24.02.1966, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me numër 038183013 dhe me numër personal G60224037I

(këtu e më poshtë quajtur "**Shitësi**")

Z. Maksim Haxhia shtetas shqiptar, i lindur në Gjirokastrë, më 03.05.1958 dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. Personal F80503035M.

(këtu e më poshtë quajtur "**Blerësi**")

Palët e mësipërme, të kësaj Kontrate, do të referohen së bashku si "**Palët**".

MEQËNËSE:

- Shoqëria "**Samasol**" shpk është person juridik i së drejtës shqiptare, regjistruar pranë Qendrës Kombetare të Biznesit me Nr. Nipt M22707403H, me seli në adresën Fier, Topojë Grykë, Njësia Administrative Topojë, Parku Solar, Fshati Grykë (më tej referuar si "**Shoqëria**"). Kjo shoqëri përbëhet nga dy ortakë të cilët janë pjesëmarrës në kapitalin e kësaj shoqërie në raportin:
 - Artur Gaçaj**, zotëruesi i një kuote të barabartë me 25% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "**Samasol**" shpk.
 - Ogert Rexha**, zotëruesi i një kuote të barabartë me 75% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "**Samasol**" shpk.
- Kapitali aktual i shoqërisë është 10.000,00 Lekë;
- Shitësi kërkon të shesë në favor të Blerësit, kuoten tij që përfaqeson 25% në kapitalin e shoqërisë, në përputhje me kushtet e kësaj kontrate duke patur miratimin paraprak të dhënë nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve sipas Vendimit të Asamblesë datë 05/07/2024 që i bashkëlidhet kësaj kontrate;
- Blerësi është i interesuar të blejë kuoten që Shitësi zotëron në Shoqëri në masën 25% të kapitalit të Shoqërisë.
- Për këto arsye, Palët, me vullnetin e tyre të plotë, të lirë e të pacënuar, vendosin të lidhin këtë Kontratë Shitblerje Kuote (në vijim referuar si "**Kontrata**"), me kushtet si më poshtë vijon:

NENI 1
OBJEKTI I KONTRATËS

- Objekti i kësaj Kontrate është transferimi i pronësisë përmes shitjes së pjesës së kuotës që Shitësi zotëron në shoqëri, në masën 25% të kapitalit të Shoqërisë, tek Blerësi Maksim Haxhia ("**Kuota**").
- Për sa më sipër, Shitësi shet dhe transferon dhe Blerësi pranon pronësinë mbi Kuotën, sipas paragrafit 1.1. me sipër, si dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo pronësi.



NENI 2



ÇMIMI I SHITJES, PAGESA DHE KALIMI I PRONËSISË

- 2.1 Shitësi do të transferojë dhe shesë Kuotën e tij në favor të Blerësit, kundrejt çmimit prej 2.500,00 Lekë (“Çmimi i Shitjes”).
- 2.2 Çmimi i Shitjes është paguar nga Blerësi dhe Shitësi deklaron se nuk ka asnjë pretendim të tashëm apo të ardhshëm në lidhje me pagimin e çmimit të shitjes.
- 2.3 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Blerësit i kalon menjëherë titulli i pronësisë mbi Kuotën që përfaqëson 25% të pjesëmarrjes në kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.
- 2.4 Me transferimin e pronësisë sipas këtij neni, Shitësi humbet çdo të drejtë pronësie, të drejtë mbi dividendin ose të drejta të tjera që lindin nga titulli i pronësisë mbi Kuotën.


NENI 3 REGJISTRIMI

- 4.1 Palët pranojnë të zbatojnë këtë kontratë dhe të japin, me kërkesë të palës tjetër dhe/ose Shoqërisë, të gjithë dokumentacionin e duhur në përgjithësi, për të kryer çdo gjë të nevojshme për transferimin e pjesëve të kapitalit, që janë objekt i kësaj Kontrate dhe për të regjistruar këtë transferim në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe në çdo organ tjetër shqiptar sipas ligjeve shqiptare në fuqi.


NENI 5 TË NDRYSHME

- 5.1 Palët garantojnë se ata e kanë lexuar dhe kanë kuptuar Kontratën dhe nenet e saj.
- 5.2 Kjo kontratë është përgatitur në 4 kopje, në gjuhën Shqipe, me vlerë të njëjtë ligjore.

SHITËSI
Artur GAÇAJ


(emër, mbiemër, nënshkrim)

BLERËSI
Maksim HAXHIA


(emër, mbiemër, nënshkrim)